



ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
ALLIANCE FOR THE FUTURE OF KOSOVA

ALEANCA

STATUTI

PËRMBAJTJA

PJESA I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	5
NENI 1	5
PARTIA POLITIKE, EMËRTIMI DHE PARIMET THEMELORE.....	5
NENI 2	5
SIMBOLET E ALEANCËS	5
NENI 3	5
DOKUMENTET THEMELTARE TË ALEANCËS.....	5
NENI 4	6
ORGANIZIMI	6
NENI 5	6
ANËTARËSIA	6
NENI 6.....	6
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT TË ALEANCËS	6
NENI 7	7
PUSHIMI I STATUSIT TË ANËTARIT	7
NENI 8.....	7
MIRËNJOHJET DHE DEKORATAT	7
PJESA II - STRUKTURA ORGANIZATIVE E PARTISË.....	8
NENI 9.....	8
NJËSITË THEMELORE TË ORGANIZIMIT	8
NENI 10.....	8
NËNDEGA	8
NENI 11	8
DEGA	8
NENI 12.....	8
DEGËT SPECIFIKE.....	8
NENI 13	9
ORGANIZIMI I ALEANCËS JASHTË KOSOVËS	9
NENI 14.....	9

KUVENDI - PËRGJEGJËSITË.....	9
(NË TË GJITHA NIVELET E ORGANIZIMIT TË ALEANCËS)	9
NENI 15.....	9
KUVENDI - ORGANIZIMI DHE FUNKSIONI	9
NENI 16.....	10
KRYESIA E PUNËS SË KUVENDIT - NË TË GJITHA NIVELET E ORGANIZIMIT TË ALEANCËS.....	10
NENI 17.....	10
KUVENDI I PARAKOHSHËM DHE KUVENDI I PUNËS - NË TË GJITHA NIVELET E ORGANIZIMIT TË ALEANCËS	10
NENI 18.....	11
KËSHILLI DREJTUES - ORGANIZIMI DHE FUNKSIONI.....	11
NENI 19.....	11
KËSHILLI DREJTUES – PËRGJEGJËSITË.....	11
NENI 20.....	12
KRYESIA - ORGANIZIMI DHE FUNKSIONI.....	12
(NË ÇDO NIVEL TË ORGANIZIMIT TË ALEANCËS).....	12
NENI 21.....	13
KRYESIA - PËRGJEGJËSITË	13
NENI 22.....	13
KRYETARI – FUNKSIONI DHE PËRGJEGJËSITË (NË ÇDO NIVEL TË ORGANIZIMIT TË ALEANCËS)	13
NENI 23.....	14
NËNKRYETARËT.....	14
NENI 24.....	14
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM.....	14
NENI 25.....	14
SEKRETARI EKZEKUTIV	14
NENI 26.....	15
ADMINISTRATA	15
NENI 27.....	15
ZËDHËNËSI I ALEANCËS	15

NENI 28.....	16
GRUPI PARLAMENTAR I ALEANCËS	16
NENI 29.....	16
KOMISIONI STATUTAR	16
NENI 30.....	16
KOMISIONI ETIK	16
NENI 31	17
ALEANCA E TË RINJVE TË KOSOVËS (ARK)	17
NENI 32.....	17
QENDRA PËR HULUMTIM DHE STRATEGJI.....	17
NENI 33.....	17
KOMISIONI PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE DHE NOMINIM	17
NENI 34.....	18
FORUMI EKONOMIK I ALEANCËS	18
NENI 35.....	18
VOTIMI	18
NENI 36.....	18
PËRFAQËSIMI I GRUAS NË TË GJITHA ORGANET UDHËHEQËSE TË ALEANCËS	18
NENI 37.....	19
MJETET PËR PUNË.....	19
NENI 38.....	19
AUDITIMI.....	19
NENI 39.....	19
ZHBËRJA E ALEANCËS.....	19
NENI 40.....	19
INTERPRETIMI I STATUTIT	19
NENI 41	20
HYRJA NË FUQI E STATUTIT TË ALEANCËS.....	20

PJESA I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 1

PARTIA POLITIKE, EMËRTIMI DHE PARIMET THEMELORE

1. Emri i partisë është: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në tekstin e mëtejme Aleanca;
2. Selia e Partisë është në Prishtinë, adresa: Bulevardi i Dëshmorëve, Nr. 49, 10000, Republika e Kosovës;
3. Aleanca është e regjistruar në regjistrin e partive politike, në organin kompetent të Kosovës;
4. Aleanca vepron në Republikën e Kosovës, ndërsa organizimi jashtë vendit bëhet në pajtim me dispozitat ligjore të shteteve përkatëse;
5. Aleanca është parti politike, qëllimet dhe parimet e së cilës janë përcaktuar me Statut dhe Program politik. Qëllimet dhe parimet formësohen edhe me anë të deklaratave, rezolutave dhe vendimeve të nxjerra nga organet e Aleancës, konform Statutit dhe Programit;
6. Organizimi dhe veprimi i Partisë përcaktohen me Statut dhe akte të tjera të veçanta;
7. Aleanca bashkëpunon me partitë tjera në Kosovë dhe vende të tjera;
8. Aleancën e përfaqëson Kryetari dhe zyrtarët tjerë të përcaktuar me këtë Statut;
9. Aleanca e garanton lirinë e plotë të zgjedhjes dhe votimit të fshehtë;
10. Aleanca garanton dhe mbron lirinë e plotë të shprehjes në të gjitha forumet e saj.

NENI 2

SIMBOLET E ALEANCËS

1. Aleanca i ka simbolet e veta dhe vulën e rrumbullakët, në të cilën shkruan: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës; Në mes të vulës shënon simboli, Aleancë, ndërsa vula e degës është e njëjtë me atë të Qendrës, ku shtohet emri i degës (dega në...). Aleanca ka edhe vulën katrore, në të cilën shkruan emri i partisë dhe selia, numri vijues në të cilin shënohet numri i protokollit dhe data.

NENI 3

DOKUMENTET THEMELTARE TË ALEANCËS

1. Programi dhe Statuti i Aleancës janë dokumentet bazë për organizimin dhe funksionimin e Partisë;
2. Statuti përcakton organizimin e brendshëm të Aleancës dhe është akti më i lartë juridik i saj;
3. Programi përcakton orientimet ideologjike dhe strategjike;

NENI 4

ORGANIZIMI

1. Aleanca është e organizuar në nëndegë dhe degë. Në raste të veçanta, konform Nenit 10 të këtij Statuti, mund të formohen edhe aktive;
2. Në strukturat e saj organizative, Aleanca ka: Kryetarin, Kuvendin, Këshillin Drejtues, Kryesinë, Grupin Parlamentar, grupet e asambleistëve, Aleancën e të Rinjve të Kosovës, departamentet profesionale, Komisionin Statutar, Komisionin Etik, Qendrën për Hulumtim dhe Strategji, Komisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve dhe Nominim, Ekipin e këshilltarëve të Kryetarit të Aleancës, Forumin Ekonomik të Aleancës, si dhe organet e tjera që mund të themelohen konform këtij Statuti.

NENI 5

ANËTARËSIA

1. Anëtar i Aleancës mund të jetë çdo qytetar i Kosovës që ka mbushur moshën 18 vjeç, dhe i cili pajtohet me Programin e Aleancës;
2. Anëtarësimi bëhet në mënyrë individuale, duke pranuar librezën e partisë, mbi bazën e deklaratimit të lirë;
3. Anëtari i Aleancës nuk mund të jetë edhe anëtar i ndonjë partie tjetër;
4. Çdo anëtar i Aleancës, pavarësisht nga funksioni në Aleancë, duhet të jetë anëtar i nëndegës së Aleancës, në vendbanimin ku jeton;
5. Nëse anëtari i Aleancës e ndërron vendbanimin, ai duhet të informojë nëndegën bazë për adresën e re dhe të regjistrohet në nëndegën e vendbanimit të ri.

NENI 6

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT TË ALEANCËS

Anëtari i Aleancës duhet të ketë bazë deleguese për t'u zgjedhur në organet udhëheqëse të Aleancës, në secilin nivel të organizimit.

Anëtari i Aleancës ka këto të drejta dhe detyrime:

1. të marrë pjesë dhe të ndihmojë në aktivitetet e Aleancës;
2. të zgjedh dhe të zgjidhet në organet udhëheqëse të Aleancës;
3. të kandidojë për institucionet e pushtetit komunal e qendror të Kosovës, në përputhje me këtë Statut;
4. të informohet me veprimtarinë e organeve drejtuese të partisë;
5. të angazhohet për realizimin e programit të partisë, të programit zgjedhor dhe të aktiviteteve të tjera të punës së Aleancës;
6. të japë propozime për punën e Aleancës.
7. t'i përmbahet Statutit, Programit, vendimeve, orientimeve dhe qëndrimeve të Aleancës;
8. të ruaj imazhin, autoritetin dhe interesat e Aleancës;

9. ta nënshkruaj Deklaratën Etike;
10. anëtarit të Aleancës, ndaj të cilit ngritet aktakuzë penale, gjatë ushtrimit të funksioneve në parti, i pushon aktiviteti në kuadër të Aleancës, deri në vendimin lirues të organeve kompetente.

NENI 7

PUSHIMI I STATUSIT TË ANËTARIT

1. Statusi i anëtarit në Aleancë, pushon:
 - a. me kërkesën e anëtarit;
 - b. me përjashtimin e anëtarit;
 - c. me vdekjen e anëtarit.
2. Vendimin për përjashtimin e anëtarit, sipas pikës 1, paragrafi b të këtij neni, e merr Kryesia e Aleancës.
3. Kryesia e Aleancës merr vendim për përjashtimin e anëtarit:
 - a. me propozim të Komisionit Etik;
 - b. me propozim të Degës;
 - c. me propozim të Kryesisë së Aleancës.
4. Propozimi për përjashtim bëhet nëse:
 - a. anëtari është anëtarësuar në subjekt tjetër politik;
 - b. merr pjesë në listë/garë zgjedhore të subjekteve të tjera politike;
 - c. merr funksion të të emëruarit politik në institucione të qeverisura nga partitë tjera pa aprovimin e Kryesisë së Aleancës;
 - d. kur me veprimet dhe qëndrimet e veta dëmton imazhin dhe funksionimin e Aleancës.
5. Kundër vendimit për përjashtim mund të bëhet ankesë në Komisionin Statutar të Aleancës, në afat prej 15 ditësh.
6. Komisioni Statutar e jep mendimin e vet për ankesën dhe ia drejton Këshillit Drejtues brenda 15 ditëve.
7. Ankesën mbi vendimin për përjashtim, si instancë e fundit, e shqyrton Këshilli Drejtues i Aleancës në afat prej 30 ditësh.
8. Vendimin për përjashtimin nga Kryesia e Aleancës, në raste të ankesës, e merr Këshilli Drejtues.

NENI 8

MIRËNJOHJET DHE DEKORATAT

1. Aleanca u ndan mirënjohje dhe dekorata personave për kontribute të veçanta për Partinë.
2. Ndarja e mirënjohjeve dhe dekoratave propozohet nga Kryesia e Aleancës, kurse atë e miraton Këshilli Drejtues. Për këtë veprim njoftohet Kuvendi i ardhshëm i Partisë.

PJESA II - STRUKTURA ORGANIZATIVE E PARTISË

NENI 9

NJËSITË THEMELORE TË ORGANIZIMIT

Njësitë themelore të organizimit dhe veprimit territorial të Aleancës janë nëndegët dhe degët.

NENI 10

NËNDEGA

1. Nëndega është njësia themelore e organizimit të Aleancës, e cila formohet në territorin e lagjeve, qyteteve apo të fshatrave. Të gjitha nëndegët e një komune e përbëjnë Degën, përveç në rastet kur me Statut të Aleancës, është e rregulluar ndryshe.
2. Me vendim të Kryesisë së Degës, nëndegët mund të formojnë aktive.
3. Në rast se veprohet sipas paragrafit 1 të këtij Neni, Kryesia e Degës miraton rregulloren e funksionimit të tyre, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.
4. Nëndegët udhëhiqen nga Kryesia e nëndegës dhe Kuvendi i nëndegës.
5. Kryesia e Aleancës, me rregullore të veçantë, e përcakton numrin dhe mënyrën e krijimit të nëndegëve.

NENI 11

DEGA

1. Dega formohet në territorin e një komune dhe përbëhet nga më së paku 5 nëndegë.
2. Kryesia e Aleancës, varësisht prej specifikave politike dhe veçorive të tjera, mund të vendos që brenda një komune të ketë më shumë se një degë.
3. Aleanca në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinë organizohet në 5 degë.
4. Organet udhëheqëse të degës janë: Kuvendi, Këshilli Drejtues, Kryetari dhe Kryesia e Degës.

NENI 12

DEGËT SPECIFIKE

1. Kryesia e Aleancës ka të drejtë t'i propozojë Këshillit Drejtues vendim të posaçëm për degën në të cilën rrezikohet funksionimi.
2. Këshilli Drejtues merr vendim për krijimin e këshillit inicues për ristrukturim të plotë të degës, aty ku ajo ka dështuar të funksionojë.
3. Në rast të një vendimi të tillë, këshilli inicues nuk i nënshtrohet provizioneve statutare që kanë të bëjnë me formën e organizimit.
4. Këshilli inicues, nën mbikëqyrjen e Kryesisë së Aleancës, duhet të shndërrohet në degë funksionale në afat prej një (1) viti.

NENI 13

ORGANIZIMI I ALEANCËS JASHTË KOSOVËS

1. Aleanca shtrihet edhe jashtë Kosovës, në diasporë dhe trojet shqiptare, në pajtim me këtë Statut dhe në pajtim me ligjet në fuqi në shtetet përkatëse.
2. Çfarëdo organizimi i Aleancës jashtë Kosovës duhet ta marrë miratimin e Kryesisë së Aleancës.
3. Strukturat e Aleancës jashtë Kosovës, në cilindo nivel, njoftohen me vendimet dhe veprimet e Aleancës.
4. Për strukturën e Aleancës jashtë Kosovës, vlejnë rregullat e parapara në këtë Statut.
5. Anëtarët e Aleancës jashtë Kosovës kanë përgjegjësi ta përkrahin Aleancën në mënyrë organizative, me kuadro si dhe me krijimin e lidhjeve më të mira me shtetet ku ata veprojnë.

NENI 14

KUVENDI - PËRGJEGJËSITË

(NË TË GJITHA NIVELET E ORGANIZIMIT TË ALEANCËS)

1. Kuvendi i Përgjithshëm është organi më i lartë vendimmarrës në Aleancë.
2. Kuvendi (varësisht nga niveli i organizimit) ka këto përgjegjësi:
 - a) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e Aleancës;
 - b) zgjedh dhe shkarkon Këshillin Drejtues;
 - c) nxjerr rekomandime, rezoluta, vendime dhe përcakton orientimet kryesore të Partisë;
 - d) miraton ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe Programit politik të Aleancës (Kuvendi i Përgjithshëm i Aleancës);
 - e) shqyrton dhe vlerëson punën e organeve qendrore të Aleancës (Kuvendi i Përgjithshëm i Aleancës);
 - f) shqyrton dhe miraton raportin e Kryesisë për aktivitetin e të gjitha organeve të Aleancës midis dy kuvendeve;
3. Formon komisione pune, si: komisionin verifikues, komisionin e votimit dhe komisione të tjera, sipas nevojës.

NENI 15

KUVENDI - ORGANIZIMI DHE FUNKSIONI

1. Kuvendi i rregullt zgjedhor mbahet një herë në katër vjet, në çdo nivel të organizimit.
2. Kuvendin e rregullt zgjedhor e thërret Kryetari i Aleancës (ngjashëm edhe për nivelet tjera të organizimit):
 - a) Kuvendi zgjedhor i punës dhe ai i jashtëzakonshëm, mbahet sipas rendit të ditës, të përcaktuar nga Këshilli Drejtues, me plotësime të mundshme në Kuvend;
 - b) Kuvendin e hap Sekretari Ekzekutiv (ngjashëm për nivelet tjera të organizimit);
 - c) Kuvendin e udhëheq Kryesia e Punës së Kuvendit.

3. Për mbajtjen e Kuvendit, delegatët njoftohen së paku 10 ditë më herët.
4. Kuvendin e nëndegës e përbëjnë të gjithë anëtarët e Aleancës në territorin e nëndegës, të cilët e zgjedhin Kryesinë e nëndegës, kryetarin, nënkryetarin, sekretarin dhe delegatët për kuvendin zgjedhor të degës.
5. Kuvendin e Degës e përbëjnë delegatët e zgjedhur në nivelin e nëndegëve (kryetari, nënkryetari dhe sekretari i nëndegës), si dhe delegatët shtesë konform Statutit dhe Rregullores për zgjedhje të brendshme.
6. Delegimi për Kuvendin Qendror të Aleancës bëhet në bazë të këtyre kritereve:
 - a) Çdo degë delegon kryetarin, nënkryetarët dhe sekretarin e përgjithshëm të degës në Kuvendin e Aleancës;
 - b) Anëtarësia e Aleancës jashtë Kosovës përfaqësohet me 20 delegatë, zgjedhja e të cilëve përcaktohet konform nenit 12 dhe 13 të këtij Statuti;
 - c) Delegatët e zgjedhur sipas paragrafëve *a dhe b*, të këtij neni, përbëjnë 40% të numrit të përgjithshëm të delegatëve të Kuvendit;
 - d) 30% e delegatëve zgjedhen në kuvendet e degëve, në proporcion me numrin e votave të fituara në zgjedhjet e fundit qendrore apo lokale;
 - e) 30% e delegatëve zgjedhen në kuvendet e degëve, në proporcion me numrin e votuesve të regjistruar në Komunë;
 - f) Numrin e saktë të delegatëve, për çdo degë, sipas pikave *d dhe e* të këtij neni, e cakton Kryesia e Aleancës, pas propozimit të Sekretarit Ekzekutiv;
 - g) Mënyra e zgjedhjes dhe kandidimit përcaktohet me Rregulloren e Aleancës për zgjedhjet e brendshme.
7. Punimet e Kuvendit janë publike, përpos në rastet kur Kryesia e punës së Kuvendit vendos ndryshe.

NENI 16

KRYESIA E PUNËS SË KUVENDIT - NË TË GJITHA NIVELET E ORGANIZIMIT TË ALEANCËS

1. Sekretari Ekzekutiv i Aleancës, (në të gjitha nivelet e organizimit) udhëheq me punimet e Kuvendit dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e Kuvendit.
2. Sekretari Ekzekutiv është përgjegjës për arkivimin e dokumentacionit të mbajtur gjatë punës së Kuvendit.
3. Kuvendi i zgjedh 4 anëtarë të Kryesisë së Punës të cilët e ndihmojnë Sekretarin Ekzekutiv në ushtrimin e detyrës së tij.
4. Mandati i Kryesisë së Punës përfundon me mbylljen e punimeve të Kuvendit.

NENI 17

KUVENDI I PARAKOHSHËM DHE KUVENDI I PUNËS - NË TË GJITHA NIVELET E ORGANIZIMIT TË ALEANCËS

1. Kuvendi i parakohshëm mund të thirret:
 - a) Në rast të shkeljeve të rënda statutare ose programore nga udhëheqja e Aleancës;

- b) Në rast të shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme;
 - c) Në rast të krizave politike dhe kushtetuese në vend;
 - d) Në rast të dorëheqjes ose pamundësisë së ushtrimit të detyrës së Kryetarit të Aleancës.
2. Kuvendin e Parakohshëm mund ta thërrasë Këshilli Drejtues:
 - a) me kërkesën e 2/3 të anëtarëve të vet;
 - b) me kërkesën e Kryesisë së Aleancës;
 - c) me kërkesën e 1/3 së delegateve të Kuvendit.
 3. Në rast të kërkesës sipas paragrafit 2 të këtij Neni (përveç pikës 1. d), Kryetari dhe Këshilli Drejtues e thërrasin Kuvendin e Parakohshëm brenda 45 ditëve, prej ditës kur është ushtruar kërkesa me shkrim.
 4. Këshilli Drejtues mund të thërrasë kuvend pune, konform paragrafit 2 dhe 3 të këtij Neni.

NENI 18

KËSHILLI DREJTUES - ORGANIZIMI DHE FUNKSIONI

1. Këshilli Drejtues zgjedhet nga Kuvendi dhe është organi më i lartë në mes të dy kuvendeve zgjedhore.
2. Këshilli Drejtues mblidhet së paku një herë në tre muaj dhe sipas nevojës. Anëtarët e Këshillit Drejtues njoftohen me datën dhe rendin e ditës së mbledhjes së paku 2 ditë përpara. Këshilli Drejtues mund të thirret edhe në mbledhje të jashtëzakonshme.
3. Këshillin Drejtues e thërret dhe udhëheq Kryetari i Aleancës (ngjashëm në të gjitha nivelet e organizimit). Mbledhjet e Këshillit Drejtues mund të thirren edhe nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit Drejtues (ngjashëm në të gjitha nivelet e organizimit).
4. Këshilli Drejtues (në të gjitha nivelet e organizimit), me propozim të Kryetarit dhe konform dispozitave të këtij Statuti, përcakton periudhën kohore për mbajtjen e zgjedhjeve të brendshme të Aleancës.
5. Këshilli Drejtues i Aleancës përbëhet nga:
 - a) Kryetari i Aleancës,
 - b) Nënkryetarët sipas Nenit 23,
 - c) Sekretari i Përgjithshëm,
 - d) Sekretari Ekzekutiv (pa të drejtë vote),
 - e) 100 anëtarë të zgjedhur drejtpërdrejt nga Kuvendi.
6. Numri i anëtarëve të Këshillit Drejtues të degës është sa dyfishi i numrit të anëtarëve të asambleve komunale.

NENI 19

KËSHILLI DREJTUES – PËRGJEGJËSITË

1. Këshilli Drejtues i Aleancës aprovon propozimin-programin dhe draft-statutin e partisë.
2. Me propozim të Kryetarit të Aleancës, Këshilli Drejtues, në të gjitha nivelet e organizimit, zgjedh dhe shkarkon Kryesinë e Aleancës, nënkryetarët dhe sekretarin e përgjithshëm.

3. Për zgjedhjen e Kryesisë së Aleancës nevojiten 2/3 e votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues. Nëse pas dy raundeve të votimit nuk zgjedhet Kryesia, në raundin e tretë nevojiten 50% +1 votë të anëtarëve të Këshillit Drejtues.
4. Me propozim të Kryetarit të Aleancës, Këshilli Drejtues miraton listën e kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Kosovës si dhe emërimet tjera politike.
5. Këshilli Drejtues i Aleancës, me propozim të Kryetarit, Kryesisë së Aleancës ose 2/3 të anëtarëve të Këshillit Drejtues, voton për shkarkimin e të emëruarve politik në kuadër të ekzekutivit.
6. Shqyrton dhe miraton çdo koalicion në çdo nivel të organizimit të Aleancës si dhe shqyrton dhe miraton çështjet konkrete programore në rast të ndonjë koalicioni të lidhur me subjekte të tjera politike në të gjitha nivelet e organizimit dhe të cilat janë të miratuara paraprakisht nga Kryesia e Aleancës.
7. Me propozimin e Kryesisë emëron anëtarët e Komisionit Statutar.
8. Me propozimin e Kryesisë emëron anëtarët e Komisionit Etik.
9. Me propozimin e Kryesisë emëron anëtarët e Komisionit për Përzgjedhjen e Kandidatëve dhe Nominim.
10. Në nivel të degës, Këshilli Drejtues propozon kandidatin për kryetar të komunës, aprovon listën preliminare për këshilltarë komunalë si dhe propozon kandidatë për deputetë në Kuvendin e Kosovës nga komuna përkatëse. Komisioni për Përzgjedhjen e Kandidatëve dhe Nominim i Aleancës i shqyrton propozimet e Këshillit Drejtues të degës dhe i dërgon te Kryetari i Aleancës dhe Këshilli Drejtues i Aleancës për aprovim përfundimtar.

NENI 20

KRYESIA - ORGANIZIMI DHE FUNKSIONI

(NË ÇDO NIVEL TË ORGANIZIMIT TË ALEANCËS)

1. Kryesia është organ i zbatimit të politikave, qëndrimeve dhe vendimeve të aprovuara në Kuvend dhe në Këshillin Drejtues të Aleancës.
2. Kryesia e Aleancës përbëhet prej:
 - Kryetarit,
 - Nënkryetarit të parë,
 - 4 nënkryetarëve,
 - Sekretarit të Përgjithshëm,
 - Anëtarëve të Kryesisë.
3. Kryesia e Nëndegës ka 7-13 anëtarë.
4. Kryesia e Degës ka anëtarë në proporcion të njëjtë me numrin e anëtarëve të asamblesë komunale, me përjashtim kur komuna ka më shumë se një degë e që është e rregulluar me Statut të Aleancës.
5. Kryesitë e degëve të Aleancës në Prishtinë përbëhen nga 21 anëtarë.
6. Kryesia e Aleancës përbëhet prej kryetarit, nënkryetarëve, sekretarit të përgjithshëm dhe 28 anëtarëve të kryesisë.
7. Kryesia është përgjegjëse për zbatimin e Programit dhe të Statutit të Aleancës.
8. Është përgjegjëse për organizimin e fushatës zgjedhore, organizimin dhe zgjerimin e anëtarësisë dhe grumbullimit të fondeve.

9. Ndarjen e përgjegjësive për funksionimin e Kryesisë e bën Kryetari i Aleancës.

NENI 21

KRYESIA - PËRGJEGJËSITË

1. Nxjerr vendime për aktivitetet e partisë.
2. Me shumicë të thjeshtë votash, miraton listën e kandidatëve për kryetarë të komunave, për këshilltarë në kuvendet komunale dhe listën e kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Kosovës, të cilën ia paraqet për aprovim Këshillit Drejtues.
3. Formon komisione dhe grupe pune për detyra konkrete.
4. I formon departamentet dhe i emëron kryesuesit e tyre.
5. Propozon Rregulloren për kuvendet zgjedhore të Aleancës (në çdo nivel të organizimit), e cila miratohet nga Këshilli Drejtues i Aleancës.
6. Vlerëson rregullësinë e kuvendeve në nivel dege dhe nëndege.
7. Në rast të shkeljeve të Rregullores ose Statutit, i drejtohet Komisionit Statutar për opinion dhe e merr vendimin final për rregullësinë, duke u bazuar në raportin e Komisionit Statutar.
8. Miraton buxhetin e Aleancës, të propozuar nga Sekretari Ekzekutiv.

NENI 22

KRYETARI – FUNKSIONI DHE PËRGJEGJËSITË (NË ÇDO NIVEL TË ORGANIZIMIT TË ALEANCËS)

1. Udhëheq dhe përfaqëson Partinë (degën ose nëndegën, varësisht nga niveli i organizimit).
2. Është përgjegjës për zbatimin e Programit dhe të Statutit të Aleancës dhe përcaktimin e orientimeve politike dhe organizative.
3. Pas vendimit të Këshillit Drejtues, thërret Kuvendin e Rregullt të Aleancës.
4. Thërret dhe udhëheq mbledhjet e kryesisë dhe këshillit drejtues.
5. Propozon dhe nënshkruan marrëveshjet politike për koalicion, memorandumet politike të të gjitha niveleve të organizimit të Aleancës, të cilat shqyrtohen dhe miratohen nga Këshilli Drejtues i Aleancës.
6. Për punën e vet i përgjigjet Kuvendit dhe Këshillit Drejtues të Aleancës.
7. Kryetari i Aleancës e ka ekipin e vet të këshilltarëve. Këshilltarët e Kryetarit të Aleancës emërohen dhe shkarkohen me vendim të Kryetarit të Aleancës.
8. Në rast të dorëheqjes apo pamundësisë së ushtrimit të funksionit, deri në Kuvendin e radhës, Kryetarin e zëvendëson Nënkryetari i Parë, e në pamundësi të tij, njëri nga nënkryetarët, i përcaktuar nga Këshilli Drejtues brenda periudhës prej 30 ditësh.
9. Në rast të zgjedhjes së tij në postin e Kryetarit të shtetit, dorëhiqet nga posti i Kryetarit të Aleancës.

NENI 23

NËNKRYETARËT

1. Aleanca ka nënkryetarin e parë dhe 4 nënkryetarë të tjerë, të cilët e ndihmojnë Kryetarin e Aleancës në ushtrimin e funksionit të tij, e zëvendësojnë dhe kryejnë detyra të caktuara, në bazë të vendimit të tij.

NENI 24

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

1. Sekretari i Përgjithshëm ka këto detyra kryesore:
 - a) Mbikëqyr zbatimin e politikave të përcaktuara nga Kryesia e Aleancës;
 - b) Ndihmon dhe mbikëqyr degët në zbatimin e vendimeve nga organet drejtuese;
 - c) Ndihmon në hartimin e programeve politike dhe trajnuese për strukturat e partisë.

NENI 25

SEKRETARI EKZEKUTIV

1. Është përgjegjës për funksionimin e përditshëm organizativ të Aleancës në të gjitha nivelet.
2. Është udhëheqës i administratës së Aleancës.
3. Zbaton vendimet e Kryesisë së Aleancës.
4. Merr pjesë në mbledhjet e Kryesisë dhe Këshillit Drejtues, pa të drejtë vote.
5. Asiston Kryetarin gjatë mbledhjeve të Kryesisë dhe Këshillit Drejtues dhe ulet menjëherë në të majtë të tij.
6. Është udhëheqës i aspekteve të komunikimit të brendshëm në të gjitha nivelet.
7. Është Shef i Shtabit Zgjedhor të Aleancës.
8. Menaxhon procesin e brendshëm zgjedhor në Aleancë.
9. Udhëheq punimet e Kuvendit të Aleancës.
10. Udhëheq me aspektet organizative, financiare, ligjore, logjistike dhe të marrëdhënieve me publikun.
11. Është përgjegjës për arkivën dhe përditësimin e bazës së të dhënave për anëtarësinë e Aleancës.
12. Për ushtrimin e detyrave të tij, bashkëpunon drejtpërdrejt me sekretarët ekzekutiv të degëve.
13. Për punën e tij, i përgjigjet Kryetarit të Aleancës.
14. Zgjedhet nga Kryetari i Aleancës, pas konkursit të brendshëm.
15. Sekretari Ekzekutiv nuk mund të kandidojë në zgjedhje lokale, në zgjedhje të përgjithshme si dhe në zgjedhje të brendshme të Aleancës gjatë ushtrimit të mandatit dhe një vit pas përfundimit të tij.
16. Kandidati për sekretar ekzekutiv duhet të ketë kualifikim të lartë arsimor.

17. Sekretarët ekzekutiv të degëve zgjedhen pas konkursit të brendshëm nga Komisioni i udhëhequr nga Sekretari Ekzekutiv i Aleancës. Sekretari Ekzekutiv i Aleancës i propozon Kryetarit të Aleancës emërimin e sekretarëve ekzekutiv të degëve, bazuar në rezultatet e intervistimit dhe në pajtim me kryetarët e degëve.
18. Përgjegjësitë e sekretarëve ekzekutivë të degëve përcaktohen me vendim të veçantë.
19. Mandati i sekretarit ekzekutiv të degëve është i njëjtë me kryetarin e degës së Aleancës, nëse nuk ka ndonjë vendim tjetër nga kryetari i degës.

NENI 26

ADMINISTRATA

1. Administrata e Aleancës udhëhiqet nga Sekretari Ekzekutiv.
2. Në administratën e Aleancës funksionojnë tri departamente: Departamenti për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Departamenti për Financa dhe Logjistikë dhe Departamenti për Organizim.
3. Në kuadër të administratës funksionojnë edhe zyrat profesionale. Zyrat profesionale e kanë udhëheqësin dhe zyrtarët të cilët zgjedhen me vendim të kryesisë sipas nevojës.
4. Zyrat janë si në vijim: Zyra për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, Zyra për Çështje të Drejtesisë, Sigurisë dhe Ligjit, Zyra për Çështje të Arsimit, Kulturës, Rinisë e Sportit, Zyra për Çështje të Shendetësisë, Çështjeve Sociale dhe Mjedisit, Zyra për Çështje të Infrastrukturës, Telekomunikacionit, Energjisë dhe Resurseve Natyrore, Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritet si dhe zyrat tjera profesionale që mund të krijohen me vendim të kryesisë.
5. Zyrat mund të kenë një ose më shumë zyrtarë profesionalë, të cilët zgjedhen me konkurs të brendshëm pasi të kenë plotësuar kriteret arsimore dhe profesionale. Këta zyrtarë intervistohen dhe përzgjedhen nga komisioni rekrutues i udhëhequr nga Sekretari Ekzekutiv i Aleancës. Të njëjtit punojnë me kontratë të rregullt pune dhe iu nënshtrohen rregullave për kandidim sikur Sekretari Ekzekutiv.
6. Zyrat zhvillojnë programe dhe politika konform Programit dhe Statutit të Aleancës.
7. Politikat ose programet e zhvilluara bëhen zyrtare pas votimit në Kryesinë e Aleancës.
8. Aleanca është pronare e të gjitha programeve dhe politikave të zhvilluara nga zyrat profesionale të Aleancës.

NENI 27

ZËDHËNËSI I ALEANCËS

1. Zëdhënësin e emëron Kryetari i Aleancës pas propozimit nga Sekretari Ekzekutiv.
2. Zëdhënësi për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të Aleancës dhe Sekretarit Ekzekutiv.

3. Zëdhënësi udhëheq me Zyren për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, në kuadër të Zyrës së Sekretarit Ekzekutiv.
4. Zëdhënësi merr pjesë në mbledhje të Aleancës, pa të drejtë vote.

NENI 28

GRUPI PARLAMENTAR I ALEANCËS

1. Grupin Parlamentar të Aleancës e përbëjnë të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës dhe deputetët tjerë, të cilët i bashkohen Grupit Parlamentar të Aleancës.
2. Grupi Parlamentar ka rregulloren e vet të punës.
3. Deputetët e Aleancës duhet të veprojnë në përputhje me interesat e Aleancës si dhe vendimet e Kryesisë dhe Këshillit Drejtues të Aleancës.

NENI 29

KOMISIONI STATUTAR

1. Komisioni Statutar është organ profesional i Aleancës:
 - a) Komisioni e ka kryetarin dhe katër anëtarë;
 - b) Anëtarët e Komisionit Statutar janë juristë me përvojë dhe anëtarë me përvojë të gjatë në Aleancë, të cilët gjatë mandatit në Komisionin Statutar nuk mund të jenë anëtarë të Kryesisë së Aleancës dhe të Këshillit Drejtues të Aleancës;
 - c) Komisioni Statutar emërohet nga Këshilli Drejtues i Aleancës, pas propozimit nga Kryesia e Aleancës.
2. Komisioni Statutar është përgjegjës për interpretimin e Statutit të Aleancës.
3. Komisioni Statutar mbron statutshmërinë dhe kontrollin e ndërsjellë të organeve të Aleancës, shqyrton ankesa dhe kërkesa të kësaj fushe nga anëtarët dhe organet e Aleancës.
4. Komisioni Statutar mblidhet sipas nevojës.
5. Vendimet e Komisionit Statutar i aprovon dhe zbaton Kryesia e Aleancës.

NENI 30

KOMISIONI ETIK

1. Komisioni Etik emërohet nga Këshilli Drejtues i Aleancës, pas propozimit nga Kryesia e Aleancës.
2. Përbëhet prej së paku, 5 (pesë) anëtarëve, të cilët e zgjedhin udhëheqësin e Komisionit.
3. Anëtarët e Komisionit Etik duhet të jenë personalitete me integritet dhe kredibilitet të lartë dhe anëtarë të devotshëm të Aleancës.
4. Komisioni Etik harton Kodin Etik të Aleancës, që miratohet nga Kryesia e Aleancës dhe mbikëqyr zbatueshmërinë e tij.

5. I rekomandon Kryesisë së Aleancës masa dhe veprime në rast të shkeljeve të Kodit Etik nga anëtarët e Aleancës.
6. I propozon Kryetarit dhe Kryesisë së Aleancës ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave.
7. E harton dhe ia propozon Kryesisë Deklaratën Etike të Anëtarit të Aleancës.

NENI 31

ALEANCA E TË RINJVE TË KOSOVËS (ARK)

1. Të rinjtë në Aleancë mund të jenë të organizuar edhe në ARK.
2. ARK ka strukturën e vet organizative. Për organizimin dhe strukturimin e ARK, organet e saj nxjerrin aktet e tyre në pajtim me këtë Statut dhe me Programin e Aleancës.
3. ARK i zgjedh të gjitha organet udhëheqëse në kuvendet e veta me mandat katërvjeçar, në jo më shumë se dy mandate.
4. Anëtar të ARK mund të jenë qytetarët e moshës deri në 30 vjeç.
5. ARK e ka Kryetarin, nënkryetarët, Kryesinë dhe Këshillin Drejtues në të gjitha nivelet.

NENI 32

QENDRA PËR HULUMTIM DHE STRATEGJI

1. Aleanca ka Qendrën për Hulumtim dhe Strategji e cila është Institut për hulumtime dhe studime politike.
2. Qendra e ruan pavarësinë në hulumtim dhe studim.
3. Qendra financohet nga donatorët.
4. Këshilli Drejtues i Aleancës e zgjedh bordin me njerëz profesionalë të fushës dhe aprovon aktet themeltare të Qendrës për Hulumtim dhe Strategji.

NENI 33

KOMISIONI PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE DHE NOMINIM

1. Komisioni për Përzgjedhje dhe Nominime bën verifikimin e të gjitha kandidaturave për pozita të zgjedhura dhe emërimet politike në të gjithë nivelet e pushtetit.
2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë të cilët propozohen nga Kryetari i Aleancës dhe votohen nga Këshilli Drejtues i Aleancës.
3. Komisioni funksionon në bazë të Rregullores së vet të cilën e aprovon Këshilli Drejtues.

NENI 34

FORUMI EKONOMIK I ALEANCËS

1. Në kuadër të Aleancës funksionon Forumi Ekonomik.
2. Anëtarë të Forumit Ekonomik, mund të jenë bizneset e anëtarëve dhe simpatizantëve të Aleancës si dhe biznese të tjera të cilat shohin interes në politikat e Aleancës.
3. Forumi Ekonomik e mban të drejtën e propozimit të programeve, politikave ekonomike dhe vendimeve të cilat kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit.
4. Forumi informohet rregullisht me të gjitha vendimet e organeve politike të Aleancës.
5. Forumi e zgjedh udhëheqësin e vet.
6. Udhëheqësi i Forumit ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e Kryesisë së Aleancës, pa të drejtë vote.

NENI 35

VOTIMI

Në të gjitha organet qendrore të Aleancës: kuvend, këshilla drejtues, kryesi dhe në të gjitha nivelet tjera organizative të Aleancës, votimi është i vlefshëm, nëse në punën e forumit marrin pjesë shumica e thjeshtë:

1. Në çdo proces zgjedhor aplikohet formula, një delegat-një votë.
2. Votimi është i vlefshëm nëse për një vendim votojnë 50%+1 të të pranishmëve.
3. Për çështjet politike dhe programore votimi është i hapur.
4. Për çështjet e kuadrove, për lista me më shumë kandidatë se numri i paraparë për t'u zgjedhur në një organ, votimi është i fshehtë.
5. Për zgjedhjen e Kryetarit të Aleancës, votimi është i fshehtë.
6. Vota e anëtarit të Aleancës është e garantuar. Anëtarit të Aleancës në asnjë mënyrë nuk mund t'i imponohet votimi. Ai në asnjë mënyrë nuk mund të detyrohet të votojë kundër vullnetit të tij.
7. Keqpërdorimi apo abuzimi me votën e lirë nga ana e anëtarit të Aleancës, sanksionohet me përjashtim të menjëhershëm nga Aleanca.

NENI 36

PËRFAQËSIMI I GRUAS NË TË GJITHA ORGANET UDHËHEQËSE TË ALEANCËS

1. Në Këshillin Drejtues, Kryesinë e Aleancës, kryesitë e degëve, gruaja merr pjesë me së paku 1/3 e anëtarëve të përgjithshëm.
2. Kryetari i Aleancës është përgjegjës për zbatimin e kësaj dispozite statutare.
3. Çdo nëndegë duhet ta ketë së paku një grua përfaqësuese në kuvendin e degës.

4. Në Kuvendin e Përgjithshëm të Aleancës, nga numri i përgjithshëm i delegatëve të degës, së paku 1/3 duhet të jenë gra.

NENI 37

MJETET PËR PUNË

1. Aleanca ka xhirollogarinë e vet.
2. Aleanca realizon të ardhura nga anëtarësia, kontributet vullnetare, donatorët, shitja e prodhimeve me emblemë të Aleancës dhe forma të tjera ligjore.
3. Aleanca mund të paguajë, sipas kontratës së punës anëtarët që kryejnë punë në organet e saj.

NENI 38

AUDITIMI

1. Kryesia e Aleancës mund të kërkojë auditim të brendshëm në çdo kohë.
2. Për auditim mund të organizojë komision profesional ose të angazhojë kompani të licencuara për auditim.

NENI 39

ZHBËRJA E ALEANCËS

Aleanca mund të pushojë së ekzistuari në këto raste:

1. Nëse për këtë vendosin 2/3 e delegatëve të Kuvendit të rregullt apo të jashtëzakonshëm.
2. Në rast të zhbërjes, për pasurinë dhe detyrimet e Aleancës vendos Kuvendi i Aleancës.

NENI 40

INTERPRETIMI I STATUTIT

1. Interpretimin autentik të këtij Statuti e bën Kuvendi apo Komisioni Statutar.
2. Në rast të konfliktit të dispozitave, Kryesia e Aleancës kërkon mendim juridik nga hartuesit e Statutit, deri në mbajtjen e Kuvendit të ardhshëm.

NENI 41

HYRJA NË FUQI E STATUTIT TË ALEANCËS

1. Statuti i Aleancës hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Aleancës:
 - a) Propozimin për plotësimin dhe ndryshimin e këtij Statuti e jep Kuvendi, Këshilli Drejtues, apo Komisioni Statutar;
 - b) Në rast të kërkesave të veçanta nga institucionet qendrore të Aleancës, ndryshimet mund t'i përpilojë një grup punues i formuar në nivel të Kryesisë së Aleancës ose Komisioni Statutar. Ato ndryshime i miraton Këshilli Drejtues dhe i voton Kuvendi i rradhës i Aleancës.

Miratuar nga Kuvendi i Punës i Aleancës, më 29.12.2019